

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                         |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë                           |
| ADRESA  | https://lapsi.al/gati-gjysma-e-shqiptareve-kane-veshtiresi-te-mbyllin-muajin-e-dyta-ne-e-urope-i1093975 |
| BURIMI  | lapsi.al                                                                                                |
| GJENDJA | online                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 18 shtator 2026, 05:17:20 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 05:14:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 6a64591068c00eb6f91eddf7a7cd9b22921bbb21fa270623e2815a1c8791aa00 |
| TEKSTI     | 0030009ed5abbc12a219c0eb5aacbe76443b1aa84642a963772a6e179f6402ac |
| PAMJA      | c724c9edc4c76cd0299f1008f4b95c3a7236d2c52ab6d5795929b35f9e1582f2 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 51f71a33dbbdd945f9e8052d9f576469696feab155bbfcc432f52e1c74fad298                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 0c0dec12bc237ce7a3b53840342154b6dec8e6e0aa6a337693272add88847ea6                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/51f71a33dbbdd945f9e8052d9f576469696feab155bbfcc432f52e1c74fad298

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë

LAPS1.AL • 18 SEPTEMBER 2026



"Duke menduar për të ardhurat totale të familjes suaj, a është familja në gjendje të mbyllë muajin, pra të paguajë shpenzimet e zakonshme të nevojshme?" Kjo është pyetja që Eurostat u bën familjeve në Europë, për të matur se sa mund ta përballojnë jetesën.

Për shumë familje shqiptare, mbyllja e muajit mbetet një mision i vështirë.

Në Shqipëri, 32.9% deklarojnë se e kanë të vështirë të mbyllin muajin, ndërsa 13.4% e kanë këtë problem në nivelin më të rëndë, duke thënë se e përballojnë jetesën me shumë vështirësi.

Të mbledhura bashkë, gati gjysma e popullsisë, konkretisht 46.3%, deklarën se e përballon jetesën me vështirësi ose shumë vështirësi, sipas të dhënave të Eurostat, që Shqipërinë, janë të disponueshme për vitin 2023.

Me këtë nivel, Shqipëria renditet e dyta në Europë, pas Greqisë, ku vështirësitë për të mbyllur muajin prekin një pjesë edhe më të madhe të popullsisë, në 67% (35% shumë të vështirë dhe 32% të vështirë). Ndërsa në Bashkimin Europian, mesatarja është vetëm 17.6% për kategoritë "me vështirësi" dhe "me shumë vështirësi", përkatësisht 11.2 dhe 6.4%, që i referohet vitit 2025.

Edhe në raport me rajonin, Shqipëria shfaqet në nivele të larta. Në Maqedoninë e Veriut përqindja e atyre që kanë vështirësi, ose shumë vështirësi të mbyllin muajin arrin në 43.8%, në Malin e Zi në 37.9% dhe në Serbi në 31.2%.

Pamundësia për të mbyllur muajin lidhet edhe me nivelin e pagave, që në Shqipëri mbetet ndër më të ulëtat në rajon.

## ide



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes manizmi

Andi Bushati



Gënjeshtër e rezortëve elitare

Blendi Kajsia

MOTITIRANA

19°C

KËMBIMIEURO

91.65

## aktuale

08:06

**Seancë brenda, protestë jashtë/Qytetarët zhvendosen para Kuvendit**

08:02



Seancë maratonë në Kuvend/ Pesë interpelanca në rend dite, sot vendoset edhe për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve



**TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë**

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



Sipas të anënave të publikuara me neret nga monitor, paga mesatare bruto në Shqipëri arriti rreth 860 euro në muaj në vitin 2025.

Në të njëjtin vit, paga bruto ishte rreth 1,290 euro në Serbi, 1,245 euro në Bosnjë-Hercegovinë, 1,206 euro në Mal të Zi dhe rreth 1,100 euro në Maqedoninë e Veriut. Vetëm Kosova, kishte një pagë mesatare bruto më të ulët prej 713 eurosh në 2025-n.

Diferenca me Bashkimin Europian është edhe më e madhe: paga mesatare bruto vjetore për një punonjës me kohë të plotë në BE ishte rreth 39,800 euro në vitin 2024, ose rreth 3,317 euro në muaj.

### **Pagat bruto vjetore, Shqipëria në fund të listës me 10 mijë euro në vit, sa një e pesta e Europës**

Presioni mbi buxhetet familjare shtohet edhe nga niveli i çmimeve. Në vitin 2025, çmimet e ushqimeve në Shqipëri arritën në 102.9% të mesatares së Bashkimit Europian, duke e kaluar për herë të parë nivelin mesatar europian. Kjo e vendos Shqipërinë edhe në krye të rajonit për nivelin e çmimeve të ushqimeve, duke e bërë diferencën mes të ardhurave dhe kostos së jetesës një tjetër faktor që rëndon mbi familjet.

### **Shqipëria shtrenjtohet më tej në 2025, çmimet e ushqimeve e kalojnë për herë të parë mesataren e BE**

#### **Si matet “Aftësia për të mbyllur muajin”**

Sipas metodologjisë së Eurostatit, treguesi “Aftësia për të mbyllur muajin” bazohet në vlerësimin e familjes për nivelin e vështirësisë që përjeton për të përballuar shpenzimet e zakonshme, duke marrë në konsideratë të ardhurat totale të familjes dhe të gjitha burimet e të ardhurave, përfshirë edhe të ardhurat e parregullta.

Shpenzimet e zakonshme përfshijnë kostot e lidhura me banesën, ndërsa përjashtohen shpenzimet e biznesit dhe të fermës.

Pyetja e përdorur në anketë është: “Duke menduar për të ardhurat totale të familjes suaj, a është familja në gjendje të mbyllë muajin, pra të paguajë shpenzimet e zakonshme të nevojshme?” Përgjigjet ndahen në gjashtë kategori: me shumë vështirësi, me vështirësi, me disa vështirësi, relativisht lehtë, lehtë dhe shumë lehtë. Për treguesin “me vështirësi ose me shumë vështirësi”, Eurostat bashkon dy kategoritë e para.


#### **Europa**

Sipas Eurostat, në vitin 2025, 17.6% e popullsisë së BE-së përjetoi vështirësi ose shumë vështirësi për të mbyllur muajin.

Në skajin tjetër, 26.4% e popullsisë ishte në gjendje ta përballonte jetesën shumë lehtë ose lehtë. Ndërsa 56.1% e popullsisë e përballonte muajin relativisht lehtë ose me disa vështirësi.

Duke i grupuar gjashtë kategoritë e aftësisë për të mbyllur muajin në dy grupe – me vështirësi dhe pa vështirësi – rezultoi se 42.5% e popullsisë së BE-së kishte të paktën disa vështirësi për të mbyllur muajin në vitin 2025.

Pesha e personave që kishin të paktën disa vështirësi ndryshonte ndjeshëm në Europë: nga 18.3% në Gjermani dhe 19.8% në Holandë, deri në 76.9% në Bullgari dhe 87.1% në Greqi.



### **Gjykata ndërkombëtare bllokoi qeverinë Rama/ Pse nuk ndërhyu SPAK për aeroportin e Vlorës**



"Të plasi trapi...": SMS-të e Ballukut në dosjen për aferën e Unazës së Tiranës



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes-man-izmi



Ndryshim rrënjësor në RTSH: Identitet i ri, programe të reja dhe pesë superprodhime

## Të këshilluara



### Rama për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve: Gjykata Kushtetuese nuk na thotë dot si votojmë

Kryeministri Edi Rama ndërhyri në Kuvend gjatë debatit për projektligjin që ndryshon formulën e pagave të gjyqtarëve dh...



### SPAK heton pagat e magjistratëve, sekuestron dokumentet në Ministrinë e Financave

Prokuroria e Posaçme ka nisur hetimet lidhur me çështjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në kuadër të ...



### Protesta kundër Speciales/ Djemtë e Thaçit dhe Veselit u bashkohen qytetarëve



### Të nominuarit për ambasadorë të SHBA-së në Serbi e Bosnje: Stabiliteti rajonal dhe frenimi i ndikimit rus e kinez, synimet kryesore

Në Komisionin për Marrëdhënie me Jashtë të Senatit amerikan, dy të nominuarit për ambasadorë amerikanë në...



### "I djeg kësula", Berisha vë Ramën në qendër të debatit për UÇK-në

Kryedemokrati Sali Berisha foli serish për denimin e katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë...



### "Fitorja" që mban peng Aeroportin e Vlorës/ Çfarë nuk tha Ministria për vendimin e Londrës

Ministria e Infrastrukturës shpalli fitore faktin që arbitri nuk pezulloj formalisht zgjidhjen e koncesionit, por dy procedurat në Londër i ndaluan qeverisë të ndryshojë status quo-në dhe, në rastin e VIA-s, të marrë në posedim aeroportin, asetet apo t'ia kalojë projektin një operatori tjetër, duke e lënë kantierin të bllokuar edhe më tej.





## Tragjedi në Athinë/ 3 të rinj shqiptarë humbin jetën në aksident



## Shoqata Evropiane e Gjyqtarëve ngre shqetësim për mos zbatimin e vendimit të Kushtetueses për pagat e magjistratëve

Bordi i Shoqatës Evropiane të Gjyqtarëve ngre shqetësim për moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me formulë...



## PAMJET/ Shqiptarët mblidhen në "Times Square" dhe këndojnë "Mora fjalë"

Shqiptarët kanë protestuar edhe në SHBA, pasi Gjykata Speciale në Hagë dënoi me 81 vite burg katër ish-krerët e UÇK-edë...



## Reagon për herë të parë pas dënimit Hashim Thaçi: Nuk kam bërë asnjë shkelje

Një ditë pas vendimit të shkallës së parë në Hagë, që dënoi me gjithsej 81 vite burg katër ish-krerë...

## Me sytë katër



22:48


## PAMJET/ 12 vite më parë Thaçi qeshte kur Albin Kurti i kërkoi të mos e votonte Specialen

Në prill të vitit 2014, kryeministri aktual i Kosovës, Albin Kurti, asokohe deputet i Parlamentit, paralajmëroi Hashim Thaçin për...




## PAMJET/ Shqiptarët "pushtojnë" gjykatën e Hagës para vendimit për krerët e UÇK-së

21:25



## "O hajdut, o hajdut..." shihni si iu ikën protestuesve Taulant Balla (VIDEO)

28:44



## PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

28:36



## Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43

## SPORT

→ Të tjerë artikuj



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.